

RITET E VDEKJES NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT:VAJTIMET NË RRETHINËNE DEÇANIT RITUALS OF DEATH IN DUKAGJINI REGION:LAMENTS IN DEÇANI WITH SORROUNDINGS

VLORË FETAJ-BERISHA

Instituti Albanologjik Prishtinë, Republika e Kosovës
vloreberisha@hotmail.com

AKTET VI, 3: 250 - 253, 2013

PERMBLEDHJE

Deçani me rrethinë është një nënkrahinë etnografike e Rrafshit të Dukagjinit në Kosovë, e cila për nga ruajtja e riteve është mjaft arkaike dhe e pa studiuar në shumë aspekte të trashëgimisë kulturore, si materiale, ashtu dhe shpirtërore. Kjo trashëgimi kulturore e shpirtërore, duke u bart gojë me gojë dhe gjenerate pas gjenerate, ka arritur të ruhet deri në ditët e sotme. Me gjithë zhvillimet e shpejta të jetës moderne, të cilat kanë ndikuar në tkurrjen dhe humbjen e shumë riteve, këtu ende janë të pranishme një serë ritesh dhe veprimesh të cilat bëhen me rastin e vdekjes, duke filluar me besimet, në shenjat paralajmëruese për vdekjen, organizimin e ceremonialit të varrimit si dhe vajin që bëhet me këtë rast. Duke i regjistruar, evidentuar dhe analizuar ato, ne kemi arritur të hedhim dritë në ndriçimin e disa prej këtyre riteve. Ato si të tilla do të jenë temë e kësaj kumtese.

Fjalë çelës: ritet e vdekjes, Deçani, trashëgimi, ceremoniali.

SUMMARY

Deçani itself and the surrounding, is an ethnographic sub-region of Rrafshi i Dukagjinit in Kosova, which for the preservation of ancient rites is very archaic and quite unexplored in many aspects of cultural heritage, both material and spiritual. This cultural and spiritual heritage, transmitted from mouth to mouth and generation after generation, has managed to preserve until today. Despite rapid developments of the modern life which have influenced the shrinkage and loss of many rites, there are still present series of rites and actions which are made in case of death, starting with the beliefs, the warning signs of death, organizing the funeral ceremony and the mourning. Those rites continues to be alive even today, in some cases, especially when the dead person is young. By recording, evidencing and analysing some of these rites, we could enlight them and try to present them in the best way in this paper.

Key-words: inheritance, death rites, Deçani, ceremonial.

HYRJE

Veçorit të cilat e dallojnë një komb nga kombet e tjera, përveç gjuhës, flamurit, simboleve kombëtare, janë edhe veshjet, këngët e vallet, ritet e ndryshme (riti i lindjes, martesës, vdekjes etj.). Janë këto veçori, të cilat në një të kaluar jo shumë të largët, kanë qenë pjesë e përditshmërisë dhe jetës e cila nuk është bërë ndryshe, por vetëm brenda këtyre rrathëve të mënyrës së të jetuarit. Ritet janë bërë, pa dallim nga familja dhe vendi se ku jetohet, fshati apo

qyteti, familjes së pasur apo të varfër. Kurse sa i përket dallimit përmbajtësor, mënyrës së trajtimit, fillimit, domethënies së ritit, kanë ekzistuar dallime si brenda fshatrave, qyteteve apo regjioneve më të vogla, po ashtu edhe në regjione etnografike më të mëdha siç është Rrafshi i Dukagjinit.

Rrafshi i Dukagjinit si njëra nga dy regjionet më të mëdha etnografike të Kosovës gjithmonë është dalluar me begatinë dhe pasurinë e kulturës materiale dhe shpirtërore. Ndikimi i faktorit kohë,

ndryshimeve në mënyrën e jetesës, lëvizjeve nga fshati në qytet si edhe luftës së fundit në Kosovë, bënë që shumë nga këto rite të pësojnë ndryshime dhe shumica të humbasin fare.

Riti i cili është ruajtur më së shumti në këtë zonë është riti i vdekjes, që është temë në këtë kumtesë.

Përshkrimi i disa riteve të vdekjes në Rrafshin e Dukagjinit

Populli shqiptar, të gjitha ngjarjet e jetës që janë zhvilluar brenda familjes i ka përcjellë me veprime, këngë e vaje, varësisht nga rasti. Ai i ka kënduar lindjes së fëmijës, martesës, ardhjes së pranverës, grumbullimit të ushqimeve për familjen, si dhe shumë veprimeve tjera që kanë të bëjnë me jetën e njeriut në përgjithësi dhe familjen në veçanti. Në mënyrë të njëjtë ka vepruar edhe me rastin e vdekjeve që e kanë përcjellë gjatë jetës.

Në këtë zonë është besuar se, para se vdekja të ndodhë, ajo shfaqet nëpërmjet disa shenjave, të cilat i paralajmërojnë njerëzit se do t'u vijë në familje. Njerëzit e kësaj ane iu kanë besuar këtyre gjërave, i kanë përcjellë dhe vërtetë pastaj edhe vdekja ka ndodhur. Shenjat të cilat banorët e kësaj zone besojnë se e paralajmërojnë vdekjen ndër të tjera janë: dhënia bukë të vdekurit apo edhe ngrënia me të në sofër, rënia e dhëmbit në ëndërr, këndimi i qyqes mbi kulmin e shtëpisë, ulërima e qenit, kur dikush i sheh ëndërr bletët apo delet besohej se do të ketë vdekje, shpatulla e pulës e shpuar, etj. (F. B. V., 2011, f. 82-83).

Lajmi për vdekjen vjen nga gratë e shtëpisë duke filluar vajin. (XH. U., 2003, f.192.) Nëse i vdekuri ndodhet në shtëpi, fillimisht rregullohet kufoma duke u kthyer nga lindja, në këtë drejtim edhe e varrosin. Vendin ku vendoset i vdekuri, "meiti" e rregullojnë me shtrojat dhe mbulojat më të mira. Pranë i ulen gratë që do të vajtojnë dhe kjo ditë quhet dita e "meitit". I gjithë organizimi rreth përgatitjes së të vdekurit, lajmërimit të farefisit, hapjes së varrit, ceremonisë së varrimit, bëhet nga farefisi, të afërmit dhe fqinjët. Zakonisht në fshatra në të shumtën e rasteve janë familje në lidhje gjaku-vëllazëri, prandaj organizohen në mes vete. Ngushëllimet i presin anëtarët e

ngushtë të familjes, si te burrat, ashtu dhe te gratë. Gjatë kohës sa qëndron kufoma në dhomë gratë e vajtojnë. Pas larjes dhe përgatitjes së kufomës, në shumicën e rasteve vendoset në një dërrasë të rrafshët sa gjatësia e trupit, që në popull njihet me emrin tabut, mirëpo në vitet e fundit trupi i të vdekurit vendoset në arkivol. Pas vendosjes, të gjithë të pranishmit duhet të parakalojnë për rreth kufomës duke i "rënë për fytyrë". Pastaj burrat e marrin kufomën për ta dërguar në varreza, në këtë moment, dikush nga gratë i largon shpejt gjërat ku kishte qëndruar kufoma dhe në atë vend vendosin një tepsi me miell dhe djathë, apo bukë e djathë, ndërsa në ditët e sotme vendosin ndonjë pako me biskota, të cilën ia japin ndonjë të varfëri, kurse vendin e fshijnë me fshesë. (A. Sh. A. K., 1987. f. 161.) Të gjitha këto veprime bëhen duke besuar dhe dëshiruar që të mos ketë vdekje të shpejtë në shtëpi, si dhe familjes t'i mbetet bereqeti. Kufomën e gruas së vdekur e përgatit "hoxhonica", kurse të burrit hoxha. Të vdekurin myslimanet e mbështjellin në qefin dhe e varrosin atë ditë. Vetëm në raste të veçanta, ritet fetare i kryen hoxha. Kurse katolikët i varrosin pasi të kenë kaluar 24 orë të veshur me veshjen më të mirë dhe stoli të cilat sipas besimit ju shërbejnë për kalimin në botën e amshuar, prifti i kryen ritet fetare. (L. B., 2007, f, 233)

E pamja vazhdon në ditët e ardhshme. Më parë e pamja zgjaste më shumë se një javë, e në ditët e sotme më së shumti zgjat, shtatë, pesë, por ka raste edhe tri ditë. (Ç. N. 2012, f. 529.) Në ndonjë rast të veçantë, kur i vdekuri nuk i ka pranë të afërmit, e pamja përfundon në ditën e varrimit.

Zija në shtëpinë e të vdekurit zgjaste një vit. Kjo çështje ishte rregulluar edhe me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Sipas Kanunit thuhet: "Zija për të dekun të shpis (për burrnim, por jo për grá) do të mbahet një vjetë". (Gj. K. Sh., 1985, f. 153.) Gjatë kohës së zisë, familja e të vdekurit visheshin me rroba më të vjetra dhe gratë nuk stoliseshin. Në fshatrat ku gratë visheshin me "veshje të katundit", term ky që i nënkupton veshjet tradicionale karakteristike të zonës, lidhësen e mbanin në ballë.

Në ato raste, kur nuses i vdiste dikush në familjen e saj, (në krah i lidhnin një litar të zi) data e dasmës nuk shtyhej, sepse ajo caktohej rëndom pesë javë më herët. Dasma në familjen e dhëndrit vazhdonte me të gjitha ritet dhe zakonet, pos muzikës. Kështu veprohej edhe kur në shtëpinë e dhëndrit ndodhte vdekja. Krushqit e sillnin së pari nusen në shtëpi e pastaj nxirrnin kufomën nga shtëpia.

Për fëmijë në familjen e gjerë nuk mbahej zi, por nëna për fëmijë zinë e mbante më gjatë, si dhe gruaja për burrë ndodhte që tërë jetën të mbante zi. (L. B. 2007, f. 238.)

Vajtimit nga rrethina e Deçanit: disa shembuj nga terreni

Vajtimit padyshim janë elementi kyç përmes të cilave janë identifikuar ritet e vdekjes të shqiptarët. Nëse për ritin e vdekjes si proces mund të themi se ka bashkëjetuar me njeriun – sepse me lindjen e tij ka pasur edhe vdekje, një gjë të tillë nuk mund të themi për vajtimit. Vajtimit për herë të parë të shqiptarët e hasim në fillim të shek. XVI, të shkruar nga Marin Barleti, në librin biografik për Skënderbeun, “Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut” (të botuar në mes të viteve 1508-1510), ku na e paraqet Lekë Dukagjnin i cili duke shkukur mjekër dhe flokë e jep lajmin për vdekjen e Skënderbeut. (B. M. 1967, F. 489.) Por, vajtimit tek shqiptarët kanë vazhduar t’i shoqërojnë ritet e vdekjes dhe kështu t’i madhërojnë ceremonitë e varrimit duke i bërë ndere dhe respekte të mëdha të vdekurve. Mirëpo, derisa në shumë zona sot ato janë zhdukur fare, ose e kemi gati te pamundur t’i gjejmë, në fshatrat e rrethit të Deçanit në Kosovë, ritet e vdekjes si edhe vajtimit që i shoqërojnë, nëse jo në formën e plotë, i gjejmë ende aktive në raste të veçanta.

Vajtimi sa është e pamja, bëhet dy ditë: ditën e “meitit”, pra në prani të kufomës ende të pavarrosur, si dhe të “tretën e ditës”, apo “ditën e gjomës”. Ditën e varrimit vajtimit përfundon në momentin kur në dhomë hynë burrat e marrin kufomën për ta dërguar në varreza. Kurse vazhdon “të tretën e ditës”, ku në dhomë improvizohet “meiti” duke e vendosur veshjen

më të mirë përmbi një dërrasë ashtu si me qenë të veshura. Pranë vendosen edhe mjete me të cilat ka punuar i vdekuri gjatë jetës si: instrumente, vegla pune, shkopi me ndihmën e të cilit ka ecur, etj. Rreth e çark në dhomë varen të gjitha veshjet e të vdekurit, vendosen fotografi të anëtarëve të familjes dhe fisit, të cilët kanë vdekur më herët por, që gjithashtu vajtohen këtë ditë. Kur vdes ndonjë burrë, i cili e ka nënën gjallë, te koka i ulet e ëma, pastaj vijnë me radhë motrat dhe vajzat, kurse gruaja - bashkëshortja e të vdekurit ulet te këmbët apo anash. Në të njëjtën mënyrë ndodh edhe kur vdes një grua: te koka i ulet nëna, vajzat dhe familjaret e tjera, varësisht se sa janë të afërta me të vdekurën, kurse burri qëndron te burrat dhe nuk i lejohet të vijë në mesin e grave.

Gratë që vijnë në “dekë” për ngushllime, veçmas bijat dhe motrat, posa të hyjnë te dera e oborrit, fillojnë të vajtojnë, duke thirrur nga tre herë: ëhëëë, ëhëëë, ëhëëë “ëëhoo-ëëhoo-ëëhoo!” - për ato raste kur i vdekuri është i vjetër, ndërkaq kur vdes ndonjë i ri, kukasin: kuuu-kuuu, kuuu-kuu,! - dhe kështu fillon vajtimit, duke hyrë në vendin (dhomën) ku gjendet kufoma dhe ulën varësisht nga afërsia dhe lidhja e gjakut dhe gjirit që kanë më të vdekurin, d.m.th duke e respektuar hierarkinë familjare. Përveç grave të familjes dhe fisit, të cilat vajtojnë me radhë, këtë ditë vajtojnë edhe vajtoret profesionale ose “njehatoret” (ato që numërojnë – njehin vlerat personale për të vdekurin), ato vijnë të përgatitura për vajtimit sepse vijnë me porosi. Vajtimit bëhet në grup, njëra nga gratë i thotë fjalët, kurse refrenin e përcjellin të pranishmet në ceremoninë mortore, si p.sh.:

E mjera nona, qe ka metë pa djalë! (vajtorja)
Kuu-kuu-kuu! (gratë e pranishme)

Roli i të pranishmëve pra, grave të cilat e përcjellin vajtores kryesore, është i një rëndësie të veçantë sepse vajtimit i jep funksionin e një vajtimit kolektiv, tragjedia është gjithëpërfshirëse, përmes tij bëhet një “katarzë” – zbrazje shpirtërore sepse. Përmes këtij vaji gratë e pranishme kujtojnë dhe vajtojnë edhe të afërmit e tyre, të cilët kanë vdekur me herët. (F. B. V, 2011, f. 105.)

Varësisht nga i vdekuri, janë thurur edhe vajtimet. Këtu do të japim disa shembuj:

Vajtimi i nënës për fëmijën, dhe motrës për vëllanë janë ndër vajtimet më prekëse në gjithë krijimtarinë popullore shqiptare, duke shprehur gjithë dhembjen dhe dashurinë për humbjen e fëmijës, krijesës që e ka sjellë në jetë, gjegjësisht dashurinë e motrës që ekziston për vëlla.

Nëna djalin e vajton kështu:

Kuku nanë, kah me ja nisë, kuuu-kuuu breee!

Qet dritë t'syve me vajtue? "

Qet dit t'zez qysh e prita , iivë- breee!

Ta shti n'dhe djalin q'e rrita, kuuu-kuuu breee " 1

Motra e vajton vëllanë kështu:

Na u sos dita për ty, kuu-kuu vlla!

Sahatin tan s'po muj me pa, "..... 2

Vajtimi i vajzës për prindër:

Baba jem, babë, ehêê - ehêê!

Qysh na le jetima, babë,..... "3

Përderisa të shqiptarët në përgjithësi ka "dy forma kryesore të vajtimeve: vajtimi i grave dhe gjamët e burrave" (I. A .P., 1987, f. 21.), te shqiptarët e rajonit të Deçanit është i njohur dhe praktikohet ende vetëm vajtimi që e bëjnë gratë, kurse sa i përket gjëmës së burrave nuk mbahet mend që është praktikuar nga më të vjetrit, përkundër faktit që kanë dëgjuar se: "në malësi edhe burrat bëjnë gjamë apo thirrin gjamë."(F. B .V., 2011, f. 81.)

Si përfundim, ritet e vdekjes në Rrafshin e Dukagjinit, ashtu si dhe te të gjithë shqiptarët, dikur kishin rregulla të caktuara dhe respektoheshin në përpikëri, ndërsa sot disa pothuajse janë zhdukur fare. Shenjat në të cilat besohej se paralajmëronin vdekjen, nuk ju beson më askush dhe ditët e të pamës janë shkurtuar nga disa javë në: 7, 3 apo edhe 1 ditë. Vajtimet në

Rrafshin e Dukagjinit në përgjithësi, përfshirë këtu edhe Deçanin në veçanti, bëhen me raste, jo në të gjitha vdekjet, e sa për gjëmën, ajo i përket një të kaluarë të largët. Është momenti i fundit që të mund të vjelët edhe diçka nga terreni, në mënyrë që të arkivohet dhe dokumentohet si një dëshmi dhe pasuri etnokulturore për brezat që vijnë pas nesh.

Literatura

Barleti, Marin, Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, Prishtinë, 1967.

Çoçaj, Nexhat, Hasi –Enciklopedi etnokulturore IV, Ritet e lindje, dasmës dhe vdekjes,"Pavarësia", Durrës, 2012.

Fetaj –Berisha, Vlore, Ritet e lindjes dhe të vdekjes në rrethinën e Deçanit, Muzeu i Kosovës, 2011.

Gjeçovi- Kryeziu. Shtjefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, libri i dy-mbë-dhjetë,. 153, Rilindja, Redaksia e boti-meve, Prishtinë, 1985.

Lajçi, Bashkim, Gjurmime etnologjike, Pejë 2007.

Shpresa Siçeca - Sazan Kullashi, Doke e zakone të Rugovës rreth lindjes, martesës e vdekjes, Rugova- monografi etnografike, A. SH. A. K., Prishtinë 1987.

Vajtime, gjamë dhe elegji, IAP, Prishtinë 1987.

Xhemaj, Ukë, Etnokultura shqiptare në Podgur (monografi etnologjike), IAP. 2003.

Burimet

1 Emine Shabanaj nga Strellci e vajton djalin e hasretit, Rrahmanin, që kishte vdekur në Pejë në një tragjedi - komunikacioni.

2 Vajtim i Mone Alaj- Kasumajt (84 vjeçare) për të vëllanë, Metë Idriz Alajn (23 vjeç) nga Drenoci.

3 Vajtim i bërë nga Hyrë Nitaj (64 vjeçare) nga Drenoci, që i kishte bërë babës, Tahirit. .